

## MARIA SOLIS KAPEDANI EMËROHET DREJTOR I PËRGJITHSHËM I DPPI-SË

**Maria Solis Kapedani**, Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, përfaqëson një nga profilet më të spikatura të fushës juridike dhe të pronësisë intelektuale në Shqipëri, me formim akademik dhe vizion të qartë europian për zhvillimin institucional dhe modernizimin e administratës publike. Është diplomuar në drejtësi pranë Universitetit të Tiranës, ndërsa ka përfunduar studimet master shkencor në të drejtën civile dhe më pas specializimin “LLM in Intellectual Property Law” pranë “Queen Mary University of London”, një nga institucionet më të njohura ndërkombëtare në fushën e pronësisë intelektuale.



Formimi i saj ndërkombëtar është pasuruar më tej me programe dhe certifikime nga “**Harvard University**”, në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të njeriut, si dhe nga “**Berklee College of Music**” në industrinë e muzikës dhe menaxhimit kreativ.

Prej vitesh, **znj. Solis Kapedani** ka ndërtuar një karrierë solide në administratën publike dhe në proceset e harmonizimit të legjislacionit shqiptar me “**acquis communautaire**” të **Bashkimit Europian**, duke mbajtur role kyçe në reformimin dhe modernizimin e sistemit të pronësisë intelektuale në vend. Ajo ka drejtuar procese të rëndësishme koordinimi, promovimi, trajnimi dhe analizash strategjike në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, si dhe ka shërbyer si Zëvendëskryetare e Kapitullit 7 për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale në kuadër të integritimit europian të Shqipërisë.

Eksperiencia e saj përfshin bashkëpunime të rëndësishme me organizata ndërkombëtare si **World Intellectual Property Organization (WIPO)**, **European Union Intellectual Property Office (EUIPO)** dhe **European Patent Office (EPO)**, ku ka kontribuar në projekte strategjike për zhvillimin e politikave të inovacionit, mbrojtjen e markave dhe patentave, edukimin mbi pronësinë industriale dhe promovimin e sipërmarrjes kreative dhe startup-eve inovative.

Përveç angazhimit institucional, **znj. Solis Kapedani** ka ushtruar rolin e mësimeve si pedagoge e jashtme në “Fakultetin e Drejtësisë” në “Universitetin e Tiranës”. Gjithashtu është autore botimesh shkencore ndërkombëtare në fushën e pronësisë intelektuale dhe bioteknologjisë, si dhe lektore në forume profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.

## SHQIPËRIA BËHET PJESË E PROJEKTIT TË RI TË BE-SË PËR PRONËSINË INTELLEKTUALE, NJË HAP I RI DREJT INTEGRIMIT EUROPIAN DHE EKONOMISË SË INOVACIONIT



**Tiranë, 20 maj 2026** – Shqipëria është përfshirë në një nga nismat më të rëndësishme të Bashkimit Evropian për forcimin e sistemit të pronësisë intelektuale në rajon, pas lançimit zyrtar të projektit **“EU4IP – Ballkani Perëndimor”**, një program i ri bashkëpunimi ndërmjet Bashkimit Evropian, Zyrës së Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPO) dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor (Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë) , si dhe Republikës së Moldavisë.

Nisma synon të mbështesë vendet pjesëmarrëse në përafrimin e legjislacionit, institucioneve dhe praktikave të tyre me standardet europiane të pronësisë intelektuale, duke krijuar kushte më të favorshme për inovacionin, investimet dhe zhvillimin ekonomik.

Projekti vjen në një moment kyç për Shqipërinë, ndërsa vendi vijon procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe përballet me nevojën për të forcuar mbrojtjen e markave tregtare, patentave, dizajneve industriale dhe të drejtave të autorit.

**Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), Maria Solis Kapedani**, e vlerësoi projektin si një mundësi të rëndësishme për të përshpejtuar transformimin e sistemit shqiptar të pronësisë intelektuale.

"Mirëpresim projektin EU4IP-WB si një hap të rëndësishëm për forcimin e ekosistemit të pronësisë intelektuale në Shqipëri dhe në të gjithë rajonin. Një sistem modern dhe efikas i mbrojtjes së pronësisë intelektuale është thelbësor për zhvillimin e inovacionit, rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve dhe afrimin e vendit me standardet europiane," u shpreh Kapedani.



Përmes këtij projekti, institucionet shqiptare do të përfitojnë asistencë teknike, shkëmbim ekspertize dhe mbështetje për harmonizimin e mëtejshëm me *acquis communautaire* në fushën e pronësisë intelektuale.

Sipas Bashkimit Evropian, sistemet e forta të pronësisë intelektuale janë një nga shtyllat kryesore të ekonomive moderne, pasi mbrojnë krijimtarinë, shpikjet dhe markat, duke nxitur investimet dhe zhvillimin e sipërmarrjes.

Drejtori Ekzekutiv i EUIPO-s, João Negrão, theksoi se një sistem i fortë i pronësisë intelektuale përbën bazën e një shoqërie më inovative dhe më të begatë.

Projekti “EU4IP – Ballkani Perëndimor” konsiderohet gjithashtu një instrument konkret i mbështetjes së Bashkimit Evropian për procesin e zgjerimit, duke ndihmuar vendet partnere të afrohen me tregun e përbashkët evropian dhe standardet e tij.

Për Shqipërinë, kjo nismë pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e klimës së biznesit, mbrojtjen e investitorëve, promovimin e inovacionit dhe rritjen e besimit të kompanive që operojnë në treg.


Rreth DPPI

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni përgjegjës për administrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë, duke kontribuar në zhvillimin e një ekonomie të bazuar në inovacion, konkurrueshmëri dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

RRETH EUIPO

Zyra e Pronësisë Intelektuale e Bashkimit Evropian (EUIPO) është një nga organizatat më të mëdha të decentralizuara të Bashkimit Evropian, me seli në Alicante të Spanjës që nga themelimi i saj në vitin 1994.

## AKTIVITET MBI PRONËSINË INTELEKTUALE NË GJIMNAZIN “ISMAIL QEMALI”



Në gjimnazin “Ismail Qemali” u zhvillua një aktivitet informues dhe edukues nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), me pjesëmarrjen e nxënësve të klasave 11-8 dhe 11-3. Gjatë këtij takimi, nxënësit u njohën me konceptet bazë të pronësisë intelektuale, të drejtën e autorit dhe rëndësinë e mbrojtjes së ideve, krijimeve artistike, projekteve teknologjike dhe çdo pune origjinale.

Përmes një prezantimi interaktiv dhe diskutimeve të hapura, të rinjtë patën mundësinë të kuptojnë më mirë vlerën e kreativitetit dhe inovacionit, si edhe përgjegjësinë që lidhet me respektimin e të drejtave të autorit. Interesi i treguar nga nxënësit, pyetjet dhe mendimet e tyre e bënë aktivitetin veçanërisht të vlefshëm dhe frymëzues.

Ky aktivitet kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve për rëndësinë e mbrojtjes së krijimtarisë dhe formimin e tyre si qytetarë të përgjegjshëm, të aftë për të vlerësuar dhe respektuar punën intelektuale të të tjerëve. Falënderojmë përfaqësuesit e DPPI-së për profesionalizmin dhe kontributin e tyre në realizimin e këtij takimi të suksesshëm.

## TRAJNIM INFORMUES ME NXËNËSIT E GJIMNAZIT “QEMAL STAFA”



Në vijim të aktiviteteve të muajit maj në bashkëpunim me sistemin e arsimit parauniversitar, u zhvillua një trajnim informues dhe ndërgjegjësues me nxënësit e gjimnazit “Qemal Stafa”. Aktiviteti synoi të ofrojë njohuri të vlefshme dhe të nxisë interesin e të rinjve për tema që lidhen me kreativitetin, inovacionin dhe rëndësinë e informimit të vazhdueshëm.

Gjatë trajnimit u prezantuan informacione dhe shembuj praktikë, të cilët u shoqëruan me diskutime interaktive dhe shkëmbim mendimesh mes pjesëmarrësve. Nxënësit treguan interes dhe angazhim aktiv, duke kontribuar me pyetje dhe reflektime mbi temat e trajtuara.

Ky aktivitet shërbeu si një mundësi e mirë për të forcuar ndërgjegjësimin dhe kulturën e informimit tek të rinjtë, duke i inkurajuar ata të zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese dhe të shohin dijen si një element kyç për suksesin e ardhshëm. Të rinjtë mbeten një forcë e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë dhe një investim i çmuar për të ardhmen.

## TRAJNIM NDËRGJEGJËSUES MBI PRONËSINË INDUSTRIALE ME NXËNËSIT E SHKOLLËS “SAMI FRASHËRI”



Në kuadër të aktiviteteve edukative për promovimin e Pronësisë Industriale tek të rinjtë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) zhvilloi një trajnim informues me nxënësit e shkollës “Sami Frashëri”. Aktiviteti synoi t’i njohë të rinjtë me rëndësinë e mbrojtjes së inovacionit, kreativitetit dhe ideve origjinale, si elementë thelbësorë për zhvillimin personal dhe profesional.

Gjatë trajnimit, nxënësit u informuan mbi konceptet bazë të Pronësisë Industriale dhe objektet kryesore të saj, duke përfshirë markat tregtare, patentat, dizajnet industriale dhe treguesit gjeografikë. Përmes shembujve praktikë dhe diskutimeve interaktive, ata patën mundësinë të kuptojnë më mirë mënyrat se si këto të drejta mbrojnë krijimet dhe shpikjet, si dhe rolin që luajnë në nxitjen e inovacionit dhe konkurrueshmërisë.

Aktiviteti u karakterizua nga interesimi dhe pjesëmarrja aktive e nxënësve, të cilët shprehën kuriozitet dhe angazhim në diskutimet mbi rëndësinë e mbrojtjes së ideve dhe krijimeve. Trajnimi kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit të tyre mbi vlerën e Pronësisë Industriale dhe rëndësinë e respektimit të të drejtave që lidhen me krijimtarinë dhe inovacionin, duke nxitur formimin e një kulture të hershme të mbrojtjes së pronës intelektuale.

## LEKSION I HAPUR MBI PATENTAT DHE MBROJTJEN E SHPIKJEVE NË SHKOLLËN “HARRY FULTZ”



Përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale zhvilluan një leksion të hapur me nxënësit e shkollës “Harry Fultz”, me fokus mbrojtjen e shpikjeve përmes patentave dhe modeleve të përdorimit. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me konceptet bazë të patentave, procedurat e aplikimit dhe regjistrimit, si dhe me mundësitë e kërkimit në regjistrat kombëtarë dhe ndërkombëtarë të patentave.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua procesit të aplikimit nëpërmjet platformës e-Albania, duke u ofruar të rinjve informacion praktik mbi hapat që duhen ndjekur për mbrojtjen e ideve dhe shpikjeve të tyre. Aktiviteti shërbeu si një mundësi e vlefshme për të rritur njohuritë e nxënësve mbi rëndësinë e pronësisë industriale dhe për të nxitur kulturën e inovacionit dhe krijimtarisë tek brezi i ri. Ky angazhim mbetet një nga prioritetet kryesore të DPPI-së në edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve.

## TAKIM NDËRGJEGJËSUES ME SUBJEKTET E HOTELERI-TURIZMIT NË SARANDË



Në kuadër të përgatitjeve për sezonin turistik, u zhvilluan takime informuese me përfaqësues të sektorit të hoteleri-turizmit në qytetin e Sarandës, me fokus rëndësinë e pronësisë industriale në mbrojtjen dhe zhvillimin e bizneseve.



Gjatë takimeve u diskutua mbi rolin e markave tregtare, identitetit të biznesit dhe produkteve autentike si elemente të rëndësishme që kontribuojnë në konkurrueshmërinë dhe suksesin e sipërmarrjeve turistike.



Pjesëmarrësit u informuan mbi përfitimet e regjistrimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, si një mënyrë efektive për të garantuar sigurinë e investimeve dhe për të rritur vlerën e biznesit në treg.

Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin e operatorëve turistikë për rëndësinë e mbrojtjes së aseteve të tyre intelektuale, veçanërisht në një destinacion me potencial të lartë turistik si Saranda.

## VIZITË STUDIMORE NË SERBI PËR SHKËMBIMIN E EKSPERIENCAVE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE

Përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) zhvilluan një vizitë studimore në Serbi, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe shkëmbimit të praktikave më të mira në fushën e pronësisë industriale. Vizita u përqendrua në shkëmbimin e eksperiencave lidhur me aktivitetet e trajnimit, ndërgjegjësimit dhe informimit të publikut.

Gjatë takimeve, përfaqësuesit e DPPI-së u njohën me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Qendrës së Trajnimeve dhe Informacionit të institucionit homolog serb, ndërsa prezantuan gjithashtu punën dhe aktivitetet e realizuara nga strukturat përkatëse të DPPI-së.



Diskutimet u fokusuan në organizimin e trajnimeve, komunikimin me grupet e interesit dhe zhvillimin e iniciativave për promovimin e pronësisë industriale. Gjithashtu, u shkëmbyen mendime dhe përvoja mbi mënyrat më efektive të ndërgjegjësimit të publikut, përfshirjen e të rinjve në aktivitete edukative, si dhe përdorimin e mjeteve moderne të komunikimit për rritjen e njohurive mbi të drejtat e pronësisë industriale.

Kjo vizitë shërbeu si një mundësi e vlefshme për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave profesionale, duke krijuar ura të reja bashkëpunimi ndërmjet institucioneve homologe.

Vizita përforcoi angazhimin për rritjen e kapaciteteve institucionale, zhvillimin e shërbimeve më cilësore për publikun dhe promovimin e vazhdueshëm të rëndësisë së pronësisë industriale në mbështetje të inovacionit dhe zhvillimit ekonomik.

